



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:160494

Datë: 15.04.2024

Numri i dokumentit: 05575886

C.nr.684/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoresh profesionale Adelina Çmega, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.H nga Rahoveci, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat S.B nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati B.O nga Rahoveci, me bazë juridike kompensimi i diferencës në pagë, kompensimi i ushqimit në punë dhe kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit, vlera e objektit të kontestit 4,807.62 euro, jashtë seancës, më datën 15.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit A.H.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit A.H, në emër të kompensimit të diferencës së pagës për kualifikim, për periudhën kohore nga data 01.12.2020, e deri me datën 31.12.2022, për 35% të pagës bazë (421.00 euro) x 35% (minusuar 58.32 euro në listën e pagave nga shuma 147.35 euro) = 89.03 euro x 25 muaj, t’ia paguaj shumën prej 2,225.75 euro, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 07.12.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm”.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit A.H, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 21.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 250 ditë pune të ja paguajë shumën prej 500.00 euro duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, me kamatë ligjore 8% nga data 25.07.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit A.H, në emër të kompensimit për udhëtim për periudhën kohore prej datës 21.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 191 ditë pune të ja paguajë shumën prej 267.40 euro duke e llogaritur nga 70% e shumës prej 1.40 euro për çdo biletë (70% i 2.00 euro = 1.40 euro), me kamatë ligjore 8% nga data 25.07.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në

afat prej 7 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

V. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit A.H në emër të kompensimit të diferencës së pagës për kualifikim, për periudhën kohore nga data 01.06.2018, e deri me datën 30.11.2020, mbi shumën prej 2,225.75 euro e deri në shumën prej 4,807.62 euro dhe atë për shumën prej 2,588.87 euro.

VI. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit A.H, t’i paguajë shumën prej 125.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm, refuzohet pjesa tjetër e shpenzimeve procedurale mbi shumën e gjykuara prej 125.00 euro e deri në shumën 229.00 euro dhe atë për shumën prej 104.00 euro.

### A r s y e t i m

Paditësi A.H, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, më datën 25.07.2023, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, ka parashtruar padinë për kompensim të diferencës në pagë, kompensimi të ushqimit në punë dhe kompensim të shpenzimeve të udhëtimit, vlera e precizuar e kërkesëpadisë është në shumën prej 4,807.62 euro.

I njëjti sipas padisë ka theksuar se ka punuar dhe vazhdon të punojë si mësimdhënës në SHFMU “Lidhja e Prizrenit” në fshatin Opterushë, në SHFMU “Faik Konica” në fshatin Celinë, SHFMU “Sadedin Hajda” në Rahovec, si dhe në SHFMU “Haki Stërmilli”, në fshatin Zoqisht, me gjithsej 20 orë mësimi në javë. Me parashtresën e datës 07.12.2023 ka precizuar kërkesëpadinë, sipas këtij precizimi ka kërkuar në emër të kompensimit të diferencës së pagës për periudhën kohore nga muaji qershor 2018 deri në muajin dhjetor 2022 (gjithsej 54 muaj) ti paguaj shumën prej 4,807.62 euro, në emër të shpenzimeve të udhëtimit për periudhën kohore nga data 21.01.2021 deri më 21.11.2022, për 191 ditë pune ti paguaj shumën prej 267.40 euro, si dhe në emër të kompensimit për ushqim për periudhën kohore nga data 21.01.2021 deri më 21.11.2022, për 250 ditë pune shumen prej 500.00 euro. Ku në bazë të këtij precizimi i ka takuar e drejta e kompensimit të ushqimit në punë dhe udhëtim sipas Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës të datës 18.04.2017, ndërsa e drejta e kompensimit të diferencës në pagë i ka takuara sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33 të datës 29.08.2008, por që deri më tani nuk është kompensuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen e saj në padi të datës 27.03.2024, ka theksuar se e kontestojmë padinë në tërësi për shkak se drejta për kompensim mbi bazën në të cilën janë thirrur palët paditëse është parashkruar. Paditësi kanë ushtruar padi në gjykatë më 25.07.2023, me të cilën kanë kërkuar kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit, për periudhën kohore nga 21.01.2021 – 21.11.2022, me mbështetje në Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017 dhe të datës 21.01.2021. Kërkesëpadinë e paditësve e konteston në tërësi edhe mbi bazën që më 21.11.2022 MASHT-i ka shkëputur

Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021 të lidhur me SBASHK. Duke shtuar se kërkesa në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës, është parashkruar. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: vendimit nr.394/2, i datës 04.03.2023, i lëshuar nga SHFMU “Sadedin Hajda” në Rahovec; vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. prot. 13122/3 i datës 06.04.2023, i lëshuar nga SHFMU “Faik Konica” në fshatin Celinë, Komuna e Rahovecit; vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. prot. 3/656 i datës 05.04.2023, i lëshuar nga SHFMU “Lidhja e Prizrenit” në fshatin Opterushë, Komuna e Rahovecit; vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 1302/2 i datës 13.04.2023, i lëshuar nga SHFMU “Haki Stërmilli” në fshatin Zoqisht, Komuna e Rahovecit; vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. prot 40/1 i datës 04.04.2023, i lëshuar nga SHFMU “Sadedin Hajda” në Rahovec; vërtetimin e çmimit të biletës së udhëtimit, i lëshuar nga Shoqata e Transportit “Kosova e Lirë” në Prizren; diplomën me numër 639 e datës 02.10.2018 e lëshuar nga Fakulteti i Arteve i Universitetit të Prishtinës; kontratën e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 334/2, e datës 02.09.2019, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit A.H; certifikata e vendbanimit prej datës 12.04.2024 dhe listën e pagave për muajin për paditësin.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditësi ka të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se paditësi për periudhën e kërkuar kohore ka prezantuar në punë. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon paditësit kompensimi i diferencës në pagë, kompensimi i ushqimit dhe udhëtimit për çdo ditë të prezencës në punë, si dhe a është parashkruar kërkesës për kompensim.

Me administrimin e vërtetimeve mbi ditët e prezencës në punë me, Nr. prot. 13122/3 i datës 06.04.2023; Nr. prot. 3/656 i datës 05.04.2023; Nr. 1302/2 i datës 13.04.2023 dhe Nr. prot 40/1 i datës 04.04.2023 gjykata vërtetoi faktin se paditësi A.H në periudhën kohore prej datës 01.12.2020 e deri më datën .11.2022 ka prezantuar në punë në 250 ditët e punës.

Me administrimin e vërtetimit të çmimit të biletës së udhëtimit i lëshuar nga Shoqata e Transportit “Kosova e Lirë” në Prizren, gjykata vërtetoi faktin se çmimi i biletës së udhëtimit në relacionin Rahovec - Celinë është 3 euro në dy drejtime, ndërsa në relacionin Rahovec - Opterushë, si dhe në relacioni Rahovec – Retij është 2 euro në dy drejtime.

Me administrimin e diplomës me numër 639 e datës 02.10.2018 e lëshuar nga Fakulteti i Arteve i Universitetit të Prishtinës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi A.H ka përfunduar studime master

Dega e Artit Figurativ - Programin Skulpturë më datën 13.07.2018 dhe mori titullin Master i Skulpturës.

Me administrimin e kontratës e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 334/2, e datës 02.09.2019, të lidhur ndërmjet paditësit A.H dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHFMU “Sadedin Hajda” në Rahovec.

Me administrimin e certifikatës së vendbanimit prej datës 12.04.2024, gjykata vërtetoi faktin se paditësi A.H jeton në Rahovec.

Me administrimin e listës së pagave për paditësin, gjykata vërtetoi faktin se, paditësi A.H kishte pagën bazë prej 421 euro, ndërsa në emër të kualifikimit i është paguar shuma prej 58.32 euro.

Kështu, gjykata ka vendosur ta aprovojë pjesën e kërkesëpadisë e paditësit lidhur me kompensimit të diferencës në pagë për shkak se në bazë të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, në pikën 1. të këtij vendimi përcaktohet që *“nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”*. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se *“mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”*. Pra, nga përmbajtja e vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008 dhe me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet dhe kriteret sipas mënyrave të përcaktuara të licencimit dhe se në bazë të këtyre kriterëve mësimdhënësve u takon kompensimi nga marrëdhënia e punës. Në këtë rast paditësit A.H në bazë të shkallës së licencimit, për shkak se posedon diplomë të nivelit Master i ka takuar kompensimi nga paga bazë prej 35 %.

Gjykata ka vendosur ta aprovojë pjesën e kërkesëpadisë të paditësit lidhur me kompensimin e ushqimit në punë për faktin se paditësi në periudhën kohore nga data 01.12.2022 e deri më datën 31.01.2023 në vendin e tij të punës ka prezantuar në 250 ditët e punës. Kjo është vërtetuar sipas vërtetimit të lëshuar nga vetë shkolla ku paditësi ka qenë duke punuar, ndërsa vërtetësinë e këtij dokumenti nuk e ka kontestuar as e paditura. Baza juridike e kërkesëpadisë buron në nenin 90 par.5 të Ligjit të Punës, ku parashihet se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Ndërsa sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 parashihet që *“Të punësuarve,*

*u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie e punës primare në institucionet arsimore”. Në rast se shumëzohen 250 ditët e prezencës në punë me nga 2 euro do të kemi shumën e përgjithshme prej 500 euro. Ndërkaq sipas nenit 35 par.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 parashihet që “Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”. Në rast se shumëzohen 191 ditët e prezencës në punë, në të cilët paditësi ka udhëtuar me 70% të shumës prej 2 euro për çdo biletë (70% i euro = 1.40 euro) do të kemi shumën e përgjithshme prej 267.40 euro.*

Gjykata vendosi ta refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit në pjesën tjetër në shumën prej 2,588.87 euro, pasi që gjykata vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës që përfshin periudhën prej datës 01.06.2018 e deri me datë 30.11.2020. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës është në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit “*Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*”. Prandaj edhe kërkesa për këtë periudhë kohore është parashkruar pasi që parashtrësia me të cilën është zgjeruar kërkesëpadia, lidhur me kompensimin e diferencës në pagë është parashtruar me datë 07.12.2023.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se “*Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë*”.

Vendimin lidhur me kamatën në lartësi prej 8%, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës, nenit 2 par.1 pika 1.2 dhe neni 35 par.5 dhe par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, nenit 398 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil  
C.nr.684/2023, më datën 15.04.2024

Bashkëpunëtorja profesionale  
Adelina Çmega

Gjyqtari  
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.